



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 0682027818

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 5775

Nr. koleksioni: 1775

Tirane më 29/06/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



A2021053950173562737



TAKSA E PULLLË
U PAGUA



KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, ne Tirane, me 29 /06 /2021, përpara meje JULIAN ZHELEGU, Noter pranë Dhomës se Noterisë Tiranë, lidhet kjo Kontrate nga dhe ndërmjet:

SHITESI: Z. Ajas Sulejmëni, shtetas shqiptar, lindur me 28.10.1983 ne Sinanaj, Tepelene, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal I31028019C, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar,

(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si "Shitësi")

dhe

BLERESI: Aurela Koraj, shtetase Amerikane, lindur në Shqiperi dhe banuese në USA, me adresë Usa, lindur më 01/06/1987, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me pasaporten amerikane me nr. 593260776.

(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si "Blerësi")

Palët e mësipërme ne vijim dhe për efekt te kësaj Kontrate, do te referohen individualisht si "Pale/a" dhe se bashku si "Pale/et".

MEOENESE:

- A. Shitësi eshte ortak dhe zoteron 22.50 % te kapitalit të regjistruar të shoqërisë "XSPORTS AEE" Sh.P.K. (ne vijim "Shoqëria"), shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS L71407028H, me seli ne Shqipëri, Tirane, Rruga "Sulejman Delvina", Njesia bashkiake nr. 5, Qendra Tregtare Olimpia, pas Postes nr. 8. kapitali themeltar i regjistruar i te cilës është ne shumen ALL 100.000,00 (njeqind mije Lekë), sikurse rezulton nga Ekstrakti i Regjistrit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- B. Shitësi dëshiron t'i shesi Blerësit ne total 22.50% (njezete e dy pike pesedhete përqind) të kapitalit te shoqërisë "XSPORTS AEE" Sh.P.K.
- C. Blerësi dëshiron te blejë konkretisht 1 kuote e cila perfaqeson 22.50 % te kapitalit te zotuar nga ortaku Ajas Sulejmëni.

PER SA ME SIPER, Palët ranë dakord për te lidhur këtë Kontrate Shitje Kuote.

KONTRATË SHITJE KUOTE

Faqja 1 nga 4



A2021053950173562737



NENI 1 OBJEKTI

- 1.1. Objekti i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë së Kuotës nga Shitësi te Blerësi dhe fitimi i pronësisë mbi 22.50% të kapitalit të zotëruar nga ortakët Ajas Sulejmëni të cilat do të transferohen në pronësi të blerësit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.

NENI 2 ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1. Çmimi i shitjes së Kuotës që përfaqëson 22.50 % (njetete e dy pike pesedhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë është 22.500 LEKE (njetete e dy mijë e pesëqind leke).
- 2.2. Çmimi i shitjes gjendet i drejtë dhe i arsyeshëm dhe Palët deklarojnë se blerësi e ka paguar përpara nënshkrimin e kontratës, cash dhe jashtë zyres noteriale dhe gjithashtu palet garantojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate nuk do të kenë asnjë pretendim të çfarëdolloji në lidhje me çmimin e shitjes dhe shprehimisht heqin dorë përfundimisht nga çdo pretendim dhe/ose rezerve dhe/ose padi në lidhje me shumën e çmimit të shitjes të përcaktuar në këtë Kontratë.

NENI 3 KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTEN

- 3.1. Pronësia mbi pjesët e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë do të kalojë nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, e cila do të regjistrohet menjëherë në librat e Shoqërisë si dhe në Regjistrin Tregtar sipas ligjit.
- 3.2. Palët shprehimisht njohin, pranojnë dhe vërtetojnë se pronësia mbi Kuotën kalon në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 3.3. Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë, me lidhjen e kësaj Kontrate, do të jetë si vijon:
- *Z. Herion Peçi mbetet zotëruar i 1 (një) kuote që përfaqëson 22.5 % (njetete e dy pike pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.*
 - *Klajdi Tahiraj mbetet zotëruar i 1 (një) kuote që përfaqëson 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.*
 - *Z. Ermal Hysesanji mbetet zotëruar i 1 (një) kuote që përfaqëson 45% (dyzetë e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.*
 - *Znj. Aurela Koraj behet zotëruar e 1 (një) kuote që përfaqëson 22.5 % (njetete e dy pike pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë.*

NENI 4 DEKLARATA DHE GARANCI

- 4.1. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:

KONTRATË SHITJE KUOTE

Faqja 2 nga 4



A2021053950173562737

- a. Shitësi është zotëruesi i vetëm i Kuotes se Shoqërisë dhe ai gëzon gjithë te drejtat e votës dhe çdo te drejte tjetër qe rrjedh nga Kuota dhe ka tagra te plota për te shitur Kuotën e zotëruar prej tij.
- b. Kuota është nënshkruar dhe paguar plotësisht.
- c. Kuota e zotëruar nga Shitësi është lirisht e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit te pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate. Shitësi i jep Blerësit garancitë më të plota të eviksionit dhe garanton se në rast se ndonjë palë e tretë do të ngrejë pretendime në lidhje me të drejta mbi Kuotën, Shitësi do të garantojë që pronësia e Blerësit mbi Kuotën të mos cenohet në asnjë mënyrë a masë.
- d. Kuota është e lirë nga çdo lloj pengu, detyrimi, takse, pretendimi, te drejte parablerjeje, apo barre tjetër dhe asnjë person i tretë nuk ka asnjë te drejtë reale apo garancie mbi Kuotën. Shitësi ka te drejte te shesë dhe t'ia transferoje Kuotën Blerësit sipas kësaj Kontrate. Blerësi fiton te drejtat e plota e te pakufizuara te pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate.
- e. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen ne kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore ne te cilat Shitësi është palë.
- f. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Shitësi garanton Blerësin se do t'i siguroje atij kontrollin efektiv te Shoqërisë në përputhje me te drejtat qe rezultojnë nga zotërimi i Kuotës.
- g. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë te vërteta, te sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime ne datën e nënshkrimit.

4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a. Blerësi ka tagra te plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve te kësaj Kontrate.
- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen ne kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore ne te cilat Blerësi është palë.
- c. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë te vërteta, te sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime ne datën e nënshkrimit.

4.3. Palët konfirmojnë se detyrimi i Blerësit për pagimin e çmimit te shitjes është përmbushur përpara lidhjes se Kontratës.

**Neni 5
DISPOZITA TE FUNDIT**

5.1. Kjo Kontrate hyn ne fuqi me nënshkrimin e saj.

5.2. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të cenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

KONTRATË SHITJE KUOTE

Faqja 3 nga 4




A2021053950173562737

- 5.3. Kjo Kontratë përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.
- 5.4. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 5.5. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Unë Noteri e hartova këtë Kontratë sipas kërkesës së Palëve në gjuhën Shqipe dhe në katër originalë e pasi ua lexova me zë të lartë e të qartë, u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur përpara meje, nënshkruhet prej tyre rregullisht në praninë time dhe unë e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë pasojat e tij.

SHITËSI


Ajan Sulejmani


BLERËSI

Arzela Kovaj


NOTERI

Julian Zhelegu





VENDIM
ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE
“XSPORTS AEE” Sh.p.k.

Sot, me datë 28.06.2021, ortaket e shoqerise “XSPORTS AEE” Sh.p.k, shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me Numer Unik Identifikimi NUIS L71407028H, moren vendimin e meposhtem:

Rendi i dites eshte:

- 1) Miratimi i transferimit permes shitjes te 22.5% te kapitalit te zoteruar nga ortaku Ajas Sulejmëni tek bleresi Aurela Koraj;
- 2) Te tjera eventuale;

Në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, asambleja e ortakeve:

VENDOSI:

1. Te miratoje transferimin permes shitjes te 22.5% te kapitalit te zoteruar nga ortaku Ajas Sulejmëni tek bleresi Aurela Koraj.
2. Te depozitroje kete vendim ne QKB duke autorizuar Znj. Malvina Piro dhe/ose Irga Sadiku, per te depozituar marreveshjen e transferimit te kuotave te kapitalit dhe te vendimit

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Ajas Sulejmëni

Ajas Sulejmëni

Klajdi Tahiraj

Klajdi Tahiraj

Ermal Hysesani

Ermal Hysesani

Herion Peçi

Herion Peçi

